

## 910 EMËR ORGANIZATE – PËRGJEGJËSI PARËSORE (VARIANTI I EMËRTIMIT)\*

Fusha 910 përmban variantin e emërtimit, që është forma e papranuar e emrit të organizatës të vendosur në fushën 710.

### Nënfushat & përsëritshmëria

| FUSHA/NËNFUSHA |  | PËRSËRITSHMËRIA |
|----------------|--|-----------------|
| 910            | Emër organizate – përgjegjësi parësore (varianti i emërtimit)* | r               |
| a              | <i>Elementi hyrës</i>  | nr              |
| b              | <i>Nënndarje</i>   | r               |
| c              | <i>Shtesa të emrit ose cilësori</i>                            | r               |
| d              | <i>Numri i mbledhjes</i>                                       | nr              |
| e              | <i>Vendi i mbledhjes</i>                                       | r               |
| f              | <i>Viti i mbledhjes</i>  | nr              |
| g              | <i>Elementi i përmbysur</i>                                    | nr              |
| h              | <i>Pjesa e emrit (jo elementi hyrës ose i përmbysur)</i>       | nr              |
| 3              | <i>Numri i regjistrimit të njësuar</i>                         | nr              |
| 5              | <i>Kodi për marrëdhënien</i>                                   | nr              |
| 9              | <i>Gjuha</i>   | nr              |

### Treguesit

| TREGUESI | VLERA | KUPTIMI  |
|----------|-------|--|
| 1        |       | <b><i>Lloji i organizatës</i></b>                          |
|          | 0     | <i>Emër organizate</i>                                     |
|          | 1     | <i>Mbledhje</i>  |
| 2        |       | <b><i>Mënyra e shënimit të emrit</i></b>                   |
|          | 0     | <i>Emër në formë të përmbysur</i>                          |
|          | 1     | <i>Emër i shënuar sipas vendndodhjes ose juridiksionit</i> |
|          | 2     | <i>Emër në renditje të drejtë</i>                          |

## PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

### 9105 Kodi për marrëdhënien

Kodi tregon marrëdhënien midis variantit të emërtimit dhe emërtimit uniform. Përdoret kodi:

|          |                |
|----------|----------------|
| <b>d</b> | <i>akronim</i> |
| <b>z</b> | <i>tjetër</i>  |

## 9109 Gjuha

Kodi tregon gjuhën e pjesës kryesore të variantit të emërimit, kur ndryshon nga gjuha e pjesës kryesore të emërimit uniform.

Për fushat e tjera vlejné udhëzimet e përshkruara te fusha 710 (shih përshkrimin e fushës 710).

## SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Nëse ekzistojné disa variante të emërtimeve fusha 910 përsëritet.

## FUSHAT NË LIDHSHMËRI

**200f** *TITULLI DHE TË DHËNAT PËR PËRGJEGJËSINË, Përgjegjësia parësore*

Në fushën 200 shënohen të dhënat në formën siç janë në njësi.

**710** *EMËR ORGANIZATE – PËRGJEGJËSI PARËSORE*

Emërtimi uniform për organizatën vendoset në fushën 910.

## SHEMBUJ

### 1. \* COBISS.net

|     |    |  |
|-----|----|--|
| 200 | 0□ | <b>a</b> Përmbledhje punimesh <b>f</b> Konferenca e 8-të e Shoqatës së Kirurgëve të Kosovës – SHKK 2013, 9 dhe 10 maj, Prishtinë |
| 710 | 12 | <b>3286867043 a</b> Shoqata e Kirurgëve të Kosovës <b>d8 f2013 e</b> Prishtinë   |
| 910 | 12 | <b>3286867043 a</b> SHKK <b>b</b> Konferenca <b>d8 f2013 e</b> Prishtinë   |

### 2. \* COBISS.net

|     |    |  |
|-----|----|--|
| 200 | 0□ | <b>a</b> Ndikimi i gjuhës angleze në gjuhën shqipe <b>f</b> Konferenca e 7-të e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës - ASHAK, Prishtinë, 8–9 dhjetor 2016 <b>g</b> [redaktor Anila Begu] |
| 710 | 02 | <b>a</b> Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës <b>d7 f2016 e</b> Prishtinë  |
| 910 | 02 | <b>a</b> ASHAK <b>d7 f2016 e</b> Prishtinë<br>(Regjistrimi i njësuar për konferencën në bazën e njësuar ende nuk ekziston, për këtë arsye nuk është nënfusha 3.)                                 |